



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; www-site:www.klsh.org.al

Nr. 1440/ 7 Prot.

Tiranë, më 27.7 2019

V E N D I M

Nr. 21 , Datë 27.7.2019

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË ARSIMORE
RAJONALE QARK DURRËS (DARD) “
“Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën
01.01.2017 deri më datën 31.12.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në “Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës” rezultoi që në përgjithësi veprimtaria e këtij institucioni është kryer në përputhje me rregullat, kuadrin ligjor dhe dispozitat e tjera që rregullojnë veprimtarinë e arsimit parauniversitar. Krahas anëve pozitive u konstatuan dhe të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, dobësi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, mungesa e akteve nënligjore apo nevoja për përmirësimin e tyre, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” të ushtruar në “Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës (DARD)”, sipas programit të auditimit nr. 1440 /1, datë 04.01.2019 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4000¹):

I. Nga auditimi financiar: Në mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e pagesave janë konstatuar disa parregullsi; janë përfshirë në pasqyrat financiare vlera e objekteve ndërtimore që janë në administrim të pushtetit vendor; mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimit fizik të aktiveve, parregullsi në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve; nuk është miratuar lista e pronave shtetërore dhe nuk janë kryer procedurat e regjistrimit të pasurisë në ZVRPP; për objektet ndërtimore mungojnë dokumentacionet respektive justifikuese si genplane, planimetri dhe plan-vendosje dhe aktet e vlerësimit, etj.

Opinion:

Nga **auditimi i pasqyrave financiare**, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), evidentohet se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara **materiale, por jo të përhapura, për të cilën japim opinion të kualifikuar²**”

II. Nga auditimi mbi përputhshmërinë³: sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti DAR Durrës, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), u evidentua në përgjithësi zbatimi tyre, por edhe disa raste të devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat kryesisht, konsistojnë në drejtim të: respektimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm publik, mungesave në plotësimin e strukturës organike, risqeve në funksionimin e portalit të punësimit të mësuesve, hartimit të rregullave të brendshme për gjurmët e auditimit në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, etj.

Opinion:

Nën gjykimin tonë, aktiviteti i DARD, kontrollet e brendshme të zbatuara paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë aktivitetin e këtij institucioni, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi.

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës u konstatuan edhe

¹ ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

²- Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, “Opinionin i kualifikuar ose me rezerve” do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

³ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të konsideruara *jo materiale* dhe *jo të përhapura*, për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**⁴.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. -Gjetje nga auditimi:

1.1.Rregullorja tip për organizimin dhe funksionimin e njësive arsimore vendore, (mbi të cilën janë hartuar rregulloret e çdo DAR/ZA-ve), është hartuar në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7592, datë 21.06.1995, që është dispozitë e shfuqizuar dhe e rënë nga fuqia nga ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

1.2.Nga analiza e pikave të rregullores dhe legjislacionit në fuqi të shërbimit civil konstatohen mospërputhje dhe kontradiksione të dispozitave, pasi nën 5, i Udhëzimit të Ministrit të MAS me nr.3, datë 18.01.2011 “Rregullore e funksionimit të DAR/ZA-ve” bie në kundërshtim me pikën nr. 9, të VKM nr. 66, datë 2.3.2010 dhe nën 22 “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013.

Konkretisht:

- referuar përcaktimeve të pikës nr. 9, të VKM nr. 66 datë 2.3.2010:

“Drejtuesi i ZA emërohet dhe largohet nga detyra nga drejtori i Drejtorisë Arsimore Rajonale që ka në varësi zyrën, ndërsa përgjegjësit e sektorit dhe specialistet e këtyre drejtorive e zyrave nga drejtuesit përkatës”;

- referuar përcaktimeve të nenit 5, të Udhëzimit të ish-Ministrit MAS me nr.3, datë 18.01.2011 “Rregullore e funksionimit të DAR/ZA-ve”, nënvizohet se:

“Përgjegjësit e sektorëve dhe specialistet e DAR dhe ZA emërohen sipas ligjit 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe largohen nga detyra nga drejtuesi i DAR dhe ZA”

- referuar përcaktimeve të nenit 22 “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.5.2013,

“Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 48 -62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.-Rekomandimi:-

Nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë:

Të merren masa për shfuqizimin e Rregullores Tip, miratuar nga Ministri MASH me Udhëzimin nr. 3, datë 18.01.2011, “Rregullore për funksionimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Zyrës Arsimore”, si akt i dalë në zbatim të ligjit nr. 7592, datë 21.06.1995, dispozitë e shfuqizuar dhe rënë nga fuqia, si dhe të hartojë një rregullore të re, e cila të harmonizohet me ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dispozitat ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar publik e kontrollin e brendshëm, si dhe aspektet e veprimit të ligjit për shërbimin civil mbi miratimin e përshkrimit të vendit të punës për secilin punonjës. Kjo rregullore të miratohet nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Brenda 60 ditëve

Nga ana e DAR Durrës:

1.Të rishikohen dhe përmirësohen dispozitat e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit DAR Durrës, miratuar me Urdhrin e Drejtorit nr. 371, datë

⁴ - Sipas *Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë* të KLSH-së, (fq.65), kapitulli V, pika 5.4, “Opinion i pakualifikuar”, Kur audituesi nuk ka raste mospërputhesh materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar

06.10.2016, (në referencë të rregullores tip të miratuar nga MAS), dhe mbi këtë bazë të kryhet përmirësimi dhe azhurnimi i saj.

Brenda 60 ditëve

2. -Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i sistemit të dokumentacionit si dhe praktikave të realizuara nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ngritur në zbatim të Urdhrit të MAS me nr.38 / 2015, “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” rezulton se ka disa çështje që në udhëzim nuk gjejnë rregullim dhe zgjidhje, krijojnë vështirësi në funksionimin e portalit dhe prandaj duhen përmirësuar e korrigjuar në kuadër të përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm mbi procesin e konkurimit dhe testimit nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”. Dobësitë në udhëzimin e mësipërm, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi procesin e konkurimit dhe testimit nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, mbartin risqe që lidhen me mos përcaktimin e rregullave të qarta për emërimin e mësuesve apo lëvizjen paralele në kuadër të marrëdhënieve të punësimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 48 -62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.-Rekomandimi:-

MASR të rishikojë dhe përmirësojë Udhëzimin e MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, në lidhje me aspektet e mëposhtme:

- a. Të korrigjohet kreu II, pika 2 e Udhëzimit, duke përcaktuar që gjithë dokumentet të jenë fotokopje të noterizuara për të shmangur rrezikun e abuzimit nga përdorimi i dokumentacionit fotokopje.
- b. Të rishikohet pika 1 e kreut II të Udhëzimit që bën klasifikimin e dokumenteve të detyrueshme, (ku 3 nga 13 dokumentet e dosjes së aplikimit, konsiderohen si dokumente të detyrueshëm, dhe mungesa e së paku njërit prej tyre sjellin dhe s’kualifikimin) dhe duke caktuar përfundimisht listën e dokumenteve për aplikim.
- c. Të qartësohen në Udhëzim procedurat e njoftimit dhe të konfirmimit nga ana e kandidatëve, pasi shumë kandidatë që banojnë në rrethe mbeten jashtë skemës së njoftimeve, sidomos në kushtet që kontaktimi dhe faktimi i kontaktimit të aplikantëve të portalit për përzgjedhjen e vendit të punës, shpesh është e vështirë të kryhet.
- d. Detyrat që i ngarkohen Komisionit të Vlerësimit, sipas kreut 2/ pika 5, kreu 5 /pika 5 dhe kreu 3 pika 3, 4, 5, tejkalojnë përgjegjësitë e anëtarëve të këtij komisioni, nëse i referohemi përbërjes së tij. Më konkretisht, Komisioni përbehet nga 4 mësues, 2 përfaqësues të prindërve, 1 punonjës psiko-social. Këta anëtarë detyrohen të përgjigjen një pune që kërkon njohuri mbi vlerësimin e dokumentacioneve ligjore, saktësi të prezantimit të të dhënave, angazhim me një kohë të konsiderueshme në proces. Këto detyra, të cilat nuk konsiderohen si kohë pune për të paguar, krahas aspekteve dhe vështirësi teknike- aspekte që zbehin ndjeshëm motivimin dhe përgjegjësinë e realizimit të procedurave nga anëtarët. Në këtë kuadër, bien prishmëritë mbi përfitimin e një produkti efikas dhe eficient gjatë procesit.
- e. Barra e vijimit të procesit që lidhen me njoftimet, kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së vendit të punës, ngarkohet thuajse totalisht mbi Kryetarin e Komisionit (punonjës i Sektorit të Kurrikulës).
- f. Dokumentacioni që hartohet nga Komisioni i Vlerësimit nuk është i unifikuar dhe i standardizuar zyrtarisht. Shkresa shoqëruese, apo çdo dokument tjetër është hartuar sipas një konceptimi që nuk ka marrë një miratim zyrtar.
- g. Ky proces duhet të kryhet dhe të ndiqet nga sektori që ka si detyrë funksionale Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, pasi është teknikisht e pamundur, qoftë edhe si kohë

fizike të punës, që një specialist i Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë të angazhohet me një punë që kërkon minimalisht një punonjës me kohë të plotë pune (*referuar ngarkesave të punës de facto që kryen komisioni*). Për më tepër, ky proces nuk lidhet me përshkrimin e punës së një punonjësi të sektorit të kurrikulës.

Brenda 3-muajve

C. MASA ORGANIZATIVE:

1. -Gjetje nga auditimi:

Në kontabilitet është regjistruar vlera e ndërtesave në shumën 14,102,490 lekë, për të cilat nuk administrohet dokumentacioni i nevojshëm teknik dhe financiar si dhe një pjesë e këtyre objekteve që mbahen në kontabilitet efektivisht janë në administrim të pushtetit vendor dhe dëmtojnë saktësinë e të dhënave të bilancit kontabël.

1. Për objektet ndërtimore mungojnë dokumentacionet respektive justifikuese si genplane, planimetri dhe plan-vendosje.
2. Auditimi konstaton se janë dërguar akte administrative shkresore nga DARD drejtë Ministrisë dhe anasjelltas, por pa finalizuar procesin e miratimit të listës së pronave dhe procedimin për regjistrimin e tyre. Pronat e DARD në vlerën 14,102,490 lekë, (të tilla sipas pasqyrimit kontabël me vlerën e tyre bruto në bilancin kontabël të datës 31.12.2017, për zërin "ndërtesa", nuk janë të regjistruara në inventarin e shtetit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe për to nuk zotërohet certifikatë pronësie. Si pasojë e mosveprimit nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji, nga ana e DARD nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", i ndryshuar .
3. Nga ana tjetër, kontabilizimi i vlerës së godinave arsimore si pjesë e DAR nuk është i drejtë sepse, në fakt ky objekt nuk është në pronësi të DAR. Në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen qendrore", pushteti lokal është kompetent, administron dhe përgjigjet për objektet arsimore. Po kështu, sipas pikave 2/b dhe c të Aneksit nr. 1, që shoqëron VKM nr. 204, datë 26.03.21998 „Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit vendor“, i ndryshuar, si dhe cilësimeve të nenit 23, pika nr.11, "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike", të ligjit nr. 139/2015, pushteti lokal është kompetent, administron dhe përgjigjet për objektet arsimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1-Rekomandimi:-

Drejtori i DARD të ngrejë një grup pune për të rakorduar me organet e vetëqeverisjes vendore dhe kryer procedurat e transferimit në përputhje me ligjin dhe pas saktësimit të kësaj situate, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme të kryejë sistemimet në kontabilitet dhe reflektojë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare të vitit 2019, për efektet e këtyre transferimeve.

Deri me 30 gusht 2019.

2. -Gjetje nga auditimi:

Nuk janë hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që DARD ka në dispozicion, plani i riveimit (kadastral dhe topografik), plan vendosjet me rrjetin koordinativ dhe ortofotot përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat se si janë organizuar si dhe formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore.

Mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës truall në administrim të DARD, (zëri “toka, troje e terrene”), ku duhet të ishte pasqyruar vlera (minimalisht) prej 8,071,440 lekë. Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” (vlera e tokës) në kontabilitet është pasqyruar për vlerën zero lekë, për sipërfaqet e evidentuara prej 780 m². Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.Rekomandimi:-

2.1.Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim të DARD bëhet domosdoshmëri vlerësimi nga ana e ekspertëve vlerësues të pavarur; azhurnimi, dhe pasqyrimi në kontabilitetin e institucionit i vlerave të pasurive zotëruese respektive, kjo në referencë të hartës së vlerës së tokave, të miratuar sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016.

2.2.Pas rakordimit me organet e qeverisjes vendore për objektet shkollore në administrimin e tyre dhe saktësimin të sipërfaqeve të tokave dhe trojeve në administrim të DARD, të kryhen përlllogaritjet dhe pasqyrohen në kontabilitet efektet financiare sa sipër.

Deri më 30 shtator 2019

3. -Gjetje nga auditimi:

Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara pasi nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër. Nuk ka një evidentim të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetim të shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit; nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit mbi informacionet e grupeve të inventarizimit, etj. Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31 -36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.-Rekomandimi:-

3.1.Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27/12/2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, bazuar në listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim dhe kritereve për vlerësimin e aktiveve. Të dokumentohen gjithë hapat e procesit për dhënien në përdorim / tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ose dhënien në përdorim a tjetërsimin e aktiveve në referencë të paragrafit 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave.

Brenda një muaji

3.2. Nga strukturat e menaxhimit të DARD të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, të ndjekin gjurmën e auditimit duke u shoqëruar me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, vend ndodhjen e groposjes së tyre, asgjësimin etj, shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e

dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Vazhdimisht

4. -Gjetje nga auditimi:

4.1.Nga auditimi u konstatua se, rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë praktika pak të zhvilluara në praktikë. Për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i “Manaxhimit të Riskut” dhe vendosja e kontrolleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e DAR. Ndonëse janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, mungon monitorimi i kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Konstatohet se:

1. *Ky dokument është hartuar pa pëcaktuar vitin dhe nuk është përditësuar.*
2. *Nuk janë hartuar risqet për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një strategji me planin e veprimit për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.*
3. *Nuk parashikohet niveli i ri i risqeve pas aplikimit të kontrolleve, referuar programit buxhetor afatmesëm, etj.*

4.2. Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve dhe plani i veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 8/a, 10 dhe 21/ 2, të ligjit nr. 10296/ 2010.

4.3.Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit të Vetëvlerësimit sipas komponentëve të MFK, konstatohet se vlerësimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar janë kryer me pikë (1-3), por nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr. 17, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pasi Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka të përfshira gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe nuk referon një plan veprimi për të ardhmen, sikundër përcaktohet në këtë udhëzim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 48 – 62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.-Rekomandimi:-

4.1.DAR Durrës, të marrë masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit dhe Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

4.2. DAR Durrës të rishikojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioritetëve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion, në zbatim të neneve 10 dhe 21, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Vazhdimisht

5. -Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi si dhe raportet periodike që DAR Durrës i ka paraqitur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nuk janë hartuar në përputhje me përcaktimet e kreut IV “*Monitorimi*”, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 22 datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, pasi nuk janë të plotësuara me informacion të plotë dhe me shpjegimet përkatëse, lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14 -24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.-Rekomandimi:-

Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore në DARD, gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të argumentojnë mosrealizimin e produkteve dhe të parashikojnë masat që duhen ndërmarrë në të ardhmen për realizimin e tyre. Institucioni të marrë masa për dorëzimin e raporteve 4-mujore të monitorimit në Ministrinë e linjës si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare, referuar Udhëzimit të sipërpërmendur.

Periodikisht, çdo katër mujor

6. -Gjetje nga auditimi:

Mbështetur në Urdhrin e Kryeministrit nr. 199, datë 01.12.2010, struktura organizative DARD ka 20 vende pune të miratuara, por nga auditimi konstatohet mungesë në 25 % të plotësisimit të pozicioneve të punës së DAR Durrës dhe konkretisht: në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë -një specialist, në Sektorin e IT-së - një specialist; në Sektorin e Programim Zhvillimit ka mungesë të përgjegjësit të sektorit dhe dy specialistë. Pra në strukturën e DARD janë pesë pozicione pune vakant, që në gjykimi tonë ndikojnë në një performacë jo të mirë të punës së institucionit. Mungesat në plotësimin e strukturës organike për DAR Durrës dhe për ZA Krujë, janë një risk operacional për arritjen e objektivave të institucioneve arsimore. Nga verifikimet e kryera në ZA Krujë, (varësi administrative e DAR Durrës) konstatohen mungesa serioze të stafit, pasi aktualisht janë vetëm 4 punonjës efektive nga 10 në strukturë, d.m.th. me mungesa të 60 % të stafit të ZA. Mosplotësimi i këtyre pozicioneve ka ardhur nga neglizhenca e DAP në publikimin e këtyre pozicioneve të punësimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24 – 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.-Rekomandimi:

Nga ana e DARD, në bashkëpunim me DAP dhe MASR, të fillojnë procedurat për rekrutimin e stafit në pozicionet vakante në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë, në Sektorin e IT-së, si dhe në Sektorin e Programim Zhvillimit.

Menjëherë

7. -Gjetje nga auditimi:

7.1.Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e DAR Durrës dhe personelin e shkollave të arsimit para universitar në varësi, janë hartuar në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj dhe jo mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë, duke mos pasqyruar prezencën e mësuesve dhe punonjësve të shkollave çdo ditë gjatë muajit, për ditët që kanë punuar. Gjithashtu, libri i pagave nuk është plotësuar për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, ku të shënohen për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave duke filluar nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto.

7.2. Dosjet personale të punonjësve janë administruar duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumenteve. Dosjet e personelit nuk janë inventarizuar, administruar me indeks të veçantë, ku të evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i inventarit të fletëve në dosje.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24 – 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.-Rekomandimi:-

7.1.Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, të marrë masa që listë prezencat mujore për punonjësit e saj dhe personelin e shkollave të arsimit para universitar në varësi, të përpilohen duke pasqyruar prezencën e mësuesve dhe punonjësve të shkollave për çdo ditë kalendarike të muajit.

Vazhdimisht

7.2.DARD të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve personale të nëpunësve dhe arsimtarëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe manualit "Mbi arkivimin e dokumenteve" dhe aktet e tjera që normojnë këtë proces.

Brenda muajit korrik 2019

8. -Gjetje nga auditimi:

Fatura tatimore e shitjes është firmosur vetëm nga ofruesi i shërbimit dhe jo nga strukturat përgjegjëse në DAR. Nuk është mbajtur asnjë procesverbal në përfundim të servisit të bërë për automjetin e institucionit, që të konfirmojë se punimet janë kryer dhe se mjeti është në gjendje pune. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për blerje të vogla të realizuara nga DARD për periudhën 2017-2018, u konstatua se mungonte relacioni nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e mallrave, për të verifikuar nëse specifikat e mallit/shërbimit të marrë në dorëzim janë në përputhje me kriteret e parashikuara. Sa sipër është vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.30, datë 27.12. 2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", paragrafët 42-50.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 31-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.-Rekomandimi:-

Institucioni të marrë masa për të gjitha rastet e kryerjes së shpenzimeve për shërbime, të përpilojë rregullisht dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton kryerjen efektive të shërbimit, apo marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës. Në të gjitha rastet, procesverbali i realizimit të shërbimit të nënshkruhet rregullisht nga komisioni, duke e bashkëlidhur me faturën e furnitorit, situacionet e shpenzimeve për shërbimet dhe riparimet, dhe dokumentuar në përputhje me kërkesat e parimet e menaxhimit financiar publik.

Vazhdimisht

9. -Gjetje nga auditimi:

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale njësia arsimore vendore nuk disponon plane të trajnimeve dhe mungon një data-base mbi regjistrimin e trajnimeve dhe kualifikimeve periodike të stafit të institucionit publik për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e pikës nr. 3/1, nënçështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016.

Nuk janë kryer trajnime të stafit në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësisë menaxhuese.

Auditimi i KLSH-së vëren se, ka një moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së përshkrimit të proceseve të punës, referuar kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, mbi përgatitjen e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës. Këto manuale garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. *Jo vetëm kaq*, por përshkrimi i procesit të punës konfondohe me përshkrimin e pozicionit të punës (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 48 – 62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.-Rekomandimi:-

9.1. Nga DAR Durrës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të merren masat e duhura për identifikimin dhe parashikimin e nevojave për trajnim si dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve në përputhje me kërkesat e ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Mbi këtë bazë të programohen dhe kryhen trajnime e seminare, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, veçanërisht mbi aspektet e analizës së menaxhimit të riskut, menaxhimit të buxhetit dhe aktiveve në dispozicion, prokurimin publik elektronik, si dhe të gjitha detyrimet e tjera, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave.

9.2. Të sigurohet pjesëmarrja në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, drejtuesve të njëjshme shpenzuese, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues, drejtuesve të shkollave si dhe specialistëve të tjerë. Detyrimi për trajnimin e stafit dhe drejtorëve të shkollave mbi aspektet e menaxhimit financiar bëhet i domosdoshëm, për faktin se ato autorizojnë pagesat e mësuesve për orët mësimore sipas normës së miratuar dhe ato mbinormë, shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, subvencionimin e teksteve shkollore për kategoritë vulnerabël, etj.

9.3. DARD të përgatisë manualin e proceseve të punës, bazuar në modelimin dhe formatet standarde të lëshuara nga struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave, për të asistuar institucionet për ta realizuar këtë proces.

Në vazhdim

10. -Gjetje nga auditimi:

Nuk janë miratuar përshkrimet e pozicioneve të punës nga Sekretari i Përgjithshëm i MASR. Nga auditimi konstatohet se, në nenin 27, “Përshkrimi i vendeve të punës”, të Rregullores së Brendshme tip, miratuar nga Ministri MASH me nr. 311/1, datë 18.1.2011, është përcaktuar se: *“Drejtori i DAR-it/ përgjegjësi i ZA-së miratojnë përshkrimin e vendit të punës për secilin punonjës. Në përshkrimin e vendit të punës së përgjegjësit të sektorit parashikohet që në një pjesë të kohës kryen detyra si specialisti sektorit”*.

Këto përcaktime të Rregullores së brendshme nuk përputhen me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë.

Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar dhe Udhëzimin e DAP nr. 2, datë 7.4.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 48 – 62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.-Rekomandimi:-

10.1.Drejtori i DAR Durrës dhe njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të koordinojë veprimet dhe miratojnë përshkrimet e punës tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Departamentin e Administratës Publike, në përputhje me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” si dhe pikës nr. 4.1.1, kreu IV, të Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 2, datë 7.4.2014 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Brenda 60 ditëve

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. -Gjetje nga auditimi:

Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për shumën **1,592,302 lekë** nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largimin e padrejtë nga puna të punonjësve. Janë likuiduar shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas urdhër shpenzimeve të kaluara në thesar për vitin 2017 dhe 2018, (në 3 raste përmes zyrës së përmbarimit dhe në 1 rast nëpërmjet likuidimit vullnetar) në shumën 1,592,302 lekë (përkatësisht 1,220 mijë në v.2017 dhe 372,302 lekë në v.2018). E gjithë shuma për ekzekutimin këtyre vendimeve gjyqësore, është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, ku përfshihen dhe pagesat e tarifave përmbarimore dhe të shpenzimeve gjyqësore.

Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24 -30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.-Rekomandimi:-

DARD të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumën e shpenzuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, pasi u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, ku përfshihen dhe tarifave përmbarimore e shpenzimet gjyqësore dhe të mos lejojë kryerjen e pagesave të kësaj kategorie pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për vendimmarrjet e gabuara të largimit të padrejtë nga puna.

Në vazhdim

2. -Gjetje nga auditimi:

Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, si pasojë e kalimit në shpenzime të vlerës së gjobës së ekzekutuar nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) në vleftën **125,200 lekë**. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 184, datë 30.06.2017 është likuiduar gjobë në shumën 125,200 lekë nga fondet e buxhetit të shtetit, për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).

Konstatohet se nuk ka analizë për pagesën e kryer për likuidim gjobe nga fondet e buxhetit të shtetit. E gjithë shuma e gjobës, si masë administrative e ngarkuar në llogarinë e institucionit është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit, meqenëse i është ngarkuar padrejtësisht fondeve buxhetore me destinacion. Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 37 -45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.-Rekomandimi:

DARD të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shenzuara për këtë shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit

Në vazhdim

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R